



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:037580

Datë: 30.10.2023

Numri i dokumentit: 04847397

C.nr.1164/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA FUSHË-KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. K. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit E. M. nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, të cilën e përfaqëson A. Sh. nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i pagave përcjellëse dhe jubilarë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 09.10.2023, me datë 23.10.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A. K. nga Prishtina me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 1,641.00 euro në emër të tri pagave jubilarë si dhe shumën prej 1,641.00 euro në emër të tri pagave përcjellëse, pra gjithsej shumën prej 3,282.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, me datë 09.03.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim të pagave përcjellëse, duke theksuar se i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune, në vendin e punës "manipulant" pranë Korporatës Energjetike të Kosovës. në momentin sa ka qenë në marrëdhënie të punës e deri me rastin e pensionit ka gëzuar të ardhura personale mujore më shumë se 700 euro, andaj të njëjtit i takojnë tri paga përcjellëse në vlerë prej 2,100.00€ dhe tri paga jubilarë nga 800 euro, në vlerë prej 2400 euro, pra gjithsej 4,500.00 euro.

Ndërsa, në seancën e datës 09.10.2023 i autorizuari i paditësit ka theksuar se kërkon nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e tij në tërësi e bazuar dhe t'i bëhet kompensimi i tri pagave jubilarë dhe tri përcjellëse, ashtu siç parashihet me Marrëveshjen Kolektive të Kosovës e cila ka qenë në fuqi prej vitit 2015-2017, andaj gjykatës i ka propozuar që të bëjë kompensimin e mjeteve, duke pasur parasysh se të ardhurat personale mujore i ka pasur në vlerë prej 547.00 € dhe ato përcjellëse 547.00 €, ashtu që në emër të tri pagave jubilarë ka kërkuar vlerën prej 1,641.00 euro, si dhe në emër të pagave përcjellëse vlerën prej 1,641.00 €, gjithsej shumën prej 3,282.00 €.

Ndërsa, sa i përket përvojës së punës ka shtuar se paditësi tek e paditura sipas librezës së punës ka punuar prej datës 07.04.1980 deri 09.10.1990, dhe prej datës 01.07.1999 deri më 13.04.2017, ndërsa gjatë periudhës 1990-1999 ka pasur ndërprerje, kështu që sipas librezës tek e paditura i bie t'i ketë pasur përvojë pune 28 vite, ndërsa pa ndërprerje prej datës 01.07.1999 deri më 13.04.2017 i bie t'i ketë 17 vite pa ndërprerë.

Ka shtuar se paditësi nuk i ka marrë pagat përcjellëse nga e paditura

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si nga baza, ashtu edhe nga lartësia, për faktin se sipas kartelës së punëmarrësit, paditësi që nga fillimi i marrëdhënies së punës, i ka plotësuar 30 vite të përvojës së punës, ku ka pasur të drejtë të kërkojë 3 paga jubilarë, por që në atë kohë nuk ka pasur Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive. Ka theksuar se deri në kohën e paraqitjes së kërkesës për përmbushjen e tri pagave jubilarë, ka arritur më tepër se 44 vite përvojë të punës, gjegjësisht 18 vite, pasi që ka arritur 30 vite të përvojës së punës, së pandërprerë, ndërsa padinë e ka paraqitur me dt. 09.03.2020, që d.m.th., paditësi 30 vite të përvojës së punës i ka arritur me dt. 07.04.2010 e që në atë kohë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, ashtu që padia e paditësit është ushtruar pas çdo afati ligjor.

Ndërsa në seancën e datës 09.10.2023 i autorizuari i të paditurit ka shtuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Për të paditurën nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura sipas datave të cekura nga përfaqësuesi i paditësit, sepse këto data gjejnë mbështetje tek provat e lëndës, por kontestuese është fakti se i padituri a i ka marrë kompensimin për tri paga përcjellëse, ndërsa në këtë seancë i ka dorëzuar gjykatës si dëshmi listën e pagave për të vërtetuar këtë fakt, ndërsa sa i përket pagave jubilarë kontestuese mbetet vetëm baza ligjore.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata, për të vërtetuar sa më saktë dhe drejtë gjendjen faktike ka administruar këto prova: Vendimi i lëshuar nga KEK me nr. 3093/0 DT 30.01.2017; Kartela e punëtorit e lëshuar nga KEK, e dt. 14.04.2017; Kartela e punëtorit e lëshuar nga KEK e dt. 06.12.2019; Libreza e përvojës së punës në emër të paditësit; Vendimi i lëshuar nga KEK me nr. 1871, i dt. 11.04.2017; Lista e pagave e datës 19.09.2023.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi tek e paditura ka punuar prej datës 07.04.1980 deri 09.10.1990 dhe prej datës 01.07.1999 deri më 13.04.2017, ndërsa gjatë periudhës 1990-1999 ka pasur ndërprerje, kështu që gjithsej ka pasur përvojë pune 28 vite, ndërsa pa ndërprerje prej datës 01.07.1999 deri më 13.04.2017 kur është pensionuar i ka 17 vite përvojë

pune pa ndërprerë. Po ashtu, nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagës mujore prej 547 euro, sepse kështu janë deklaruar palët ndërgjyqëse në seancën e datës 09.10.2023.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse sa i përket pagës jubilarë ishte vetëm baza ligjore, ndërsa sa i përket pagave përcjellëse kontestuese në mes të palëve ishte fakti se a e ka pranuar paditësi nga e paditura shpërblimin në emër të tri pagave përcjellëse nga 547 euro, pra gjithsej 1.641.00 euro.

Gjykata, faktin se paditësi i ka pranuar nga e paditura shpërblimin në emër të pagave përcjellëse, e vërtetoi nga lista e pagave, e datës 19.09.2023, në të cilën figuron se e paditura i ka paguar paditësit me datë 14.04.2017, përveç tjerash edhe shumën prej 1,641.00 euro.

Andaj, pasi që gjykata vërtetoi faktin se e paditura e ka përmbushur detyrimin të cilin e kërkon paditësi, pra pagesën për tri paga përcjellëse, gjykata vendosi që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Ndërsa, gjykata po ashtu vendosi që ta refuzojë si të pabazuar edhe kërkesën e paditësit për pagesën e tri pagave jubilarë, pasi që nga gjendja faktike e shtjelluar më lart, u vërtetua se paditësi ka arritur moshën e pensionit me datë 13.04.2017, e në atë kohë i ka pasur 17 vite përvojë pune pa ndërprerë, që d.m.th. vitin jubilar e ka arritur në vitin 2010, ndërsa në atë kohë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK), por e njëjta, ka hyrë në fuqi më 01.01.2015. Për ta plotësuar kushtin për kompensim në emër të shpërblimit jubilar, gjykata vlerëson se duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë komulative, kushti i parë është që viti jubilar, e në këtë rast 10 vite, të jetë arritur gjatë kohës sa ka qenë kontrata kolektive e lartcekur në fuqi, dhe kushti i dytë që përvoja e punës jubilarë të jetë pandërprerë tek punëdhënësi i fundit. Ndërsa, siç u vërtetua më lart, paditësi vitin jubilar prej 10 vitesh e ka arritur gjatë kohës sa nuk ka qenë në fuqi MPKK, dhe rrjedhimisht kërkesa e paditësit për shpërblim jubilar është e pabazë ligjore. Ky interpretim është në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 27.02.2023, me numër 40/2023.

Me nenin 319 të LPK-së është paraparë që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Me këtë dispozitë rregullohet çështja e të provuarit të fakteve mbi të cilat secila palë e bazon kërkesën dhe pretendimet e saja, e në këtë rast paditësi nuk ka arritur që ta provojë faktin kryesor në këtë çështje juridike kontestimore sa i përket kërkesës për kompensimin e tri pagave përcjellëse, pra faktin se nuk i ka pranuar ato nga e paditura, ndërsa në anën tjetër e paditura me provat e lartcekura, dhe gjendjen faktike të vërtetuar si më lart, ka arritur ta provojë faktin i ka paguar paditësit kompensimin për tri pagat përcjellëse në pension.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së, pasi që pala që ka pasur sukses në këtë procedurë, përkatësisht i padituri, nuk ka pasur shpenzime të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:037580
Datë: 30.10.2023
Numri i dokumentit: 04847397

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1164/20, datë 23.10.2023

Gjyqtari

Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.